

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

AEJ 22 shpk

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit , Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare sot me date **19/09/2022** me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **AEJ 22 shpk**.

KREUI

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1 Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **AEJ 22 Shpk**.

Neni 2 Forma Juridike

Shoqeria **AEJ 22** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga nga ortaku i vetem, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3 Selia

Shoqeria e ka seline ne Fier, Qendra administrative Cakran, Lagjja “Kodhelaj” Rruga: Cakran Varibop Km 1. Nd.73; H1; Cakran Fier.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetem të Shoqërisë.

Neni 4 Objekti

Shoqeria **AEJ 22** shpk ka per objekt kryerjen e cdo aktiviteti te lejuar me ligj dhe/ ose pjesemarrje ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe, ne vecanti: Prodhim inertesh, i mjaterialeve te ndertimit dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice brenda dhe jashte vendit per ndertime civile ushtarake, private, social kulturore etj.

Tregtim me shumice dhe pakice i mallrave industriale, makinerive, pajisjeve dhe pjese kembimi te ndryshme, import eksport i mallrave, makinerive pajisjeve dhe materiale ndertimi, te pajisjeve hidraulike dhe elektrike, tregtim i pajisjeve te ndryshme elektroshtepiake, elektronike, hidrosanitare, qeramike dhe te artizanatit. Import eksport me shumice dhe pakice te sistemeve te kondicionim ventimilit, te sistemeve te ngrohjes, kaldajave etj.

Import eksport, tregetim me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, artikuj bujqesor dhe blegtorale, paisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, konfeksione, metrazhe, lende kimike. Grumbullim, perpunim, eksport dhe tregetim me shumice e pakice te bimeve medicinale, produkteve dhe nenprodukteve bujqesore, blegtorale dhe pyjore. Restorant bar bufe, servis mjetesh.

Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II **KAPITALI**

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 lekë dhe eshte nënshkruar nga “ ortaku i vetem i shoqerise.

Ortaku Themelues: Sosë Avdulaj, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlere te pergjithshme 100 Leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pasi te dali NIPTI i shoqerise .

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e të paktën tri të katërtave të zoteruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10 **Administrimi**

Administrator i shoqerise **AEJ 22** shpk eshte znj. Sose Avdulaj, atesia Asqeri, e datelindjes 07/05/1980, lindur ne Fier e banues ne Cakran Fier, shtetas shqiptar, me Nr Personal:

I05507016I e cila do te ushtroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise.

Neni 11 **Kompetencat**

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të dy bashke :

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblese se ortakeve edhe ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13 **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Neni 14 **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15 **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 15 **Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **AEJ 22** shpk, dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

SOSË AVDULAJ